



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. _____ Prot.

Kukës me, _____.____.2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. 29 Datë 22.05.2024

PËR

MIRATIMIN ME SHKRIM PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIMIN E KATEGORISË SË PERDORIMIT TË FONDIT PYJOR PUBLIK TË SIPERFAQES 0,677 HA. SHFRYTËZIM MINERAL KROMI ME KARRJERË NË FUNKSION TË AKTIVITETIT TË SHOQËRISË “PEPA GROUP” SH.P.K LEJE MINERARE Nr.1886/1

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015 te miratuar me date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjin Nr.44/2015, te miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2005, “Për pyjet” neni 5, ligji Nr.9693, date 19.03.2007 “Per fondin kullosor” (i ndryshuar) neni 10, VKM Nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive” (i ndryshuar), VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhenies ne perdorim dhe ndryshimin e kategorie se perdorimit,procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve dhe pakesimin ne volum nga fondi pyjore kombetar apo zgjerimin e tyre”, VKM Nr.592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, (i ndryshuar), pika 6/d, si dhe shkreses se Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit Nr 2879 Prot. date 26.04.2024, i propozoj Keshillit Bashkiak Kukes, te:

MIRATOJE:

1.-Me shkrim vazhdimin e procedurave te ndryshimit te kategorie se perdorimit te fondit pyjore kombetar publik per aktivitetin minerar te shfrytezimit kromit me karrjere per objektin “Surroj” per siperfaqen 0,677 ha e cila ndodhet ne nen/ngastren 92/b te ekonomise pyjore “Mamez-Kalimash”, Bashkia Kukes..

2.-Verifikimi i ligjshemirise se aktit nga Prefekti,ne perputhje me legjislacionin ne fuqi sipas pikes 2/d kreu III te VKM Nr 888 date 27/12/2022.

3.-Raporti tekniko-ekonomik se bashku me vendimin e keshillit bashkiak do t'i dergohet Ministrise se Turizimit dhe Mjedisit, per vijimin e proçedurave ligjore per ndryshimin e kategorise se perdorimit te fondi pyjor/kullosor sipas pikes 6 kreu II te VKM Nr 888 date 27/12/2022.

4.-Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria Administrimit Pyjeve dhe kullotave dhe Drejtoria Juridike dhe prokurimeve Publike.

KRYETARI

Albert HALILAJ



Konceptoi:S.Hallaci

Ligjshmeria:H.Muja

Sekretari:E.Ramallari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

RELACION

KESHILLIT BASHKIAK KUKES

PËR

MIRATIMIN ME SHKRIM PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PER NDRYSHIMIN E KATEGORISË SË PERDORIMIT TE FONDIT PYJOR PUBLIK TE LEJES MINERARE 1886/1 TE SIPERFAQES 0,677 HA.

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015 te miratuar me date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore" nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjin Nr.44/2015, te miratuar me datë 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative të RSH", ligjit Nr.57/20, datë 30.04.2020, "Për pyjet" neni 5, ligji Nr.9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullosor" (i ndryshuar) neni 10, VKM Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive" (i ndryshuar), me VKM-në Nr.684, datë 02.90.2020. VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhenies ne perdorim dhe ndryshimin e kategorise se perdorimit, procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve dhe pakesimin ne volum nga fondi pyjore kombetar apo zgjerimin e tyre", VKM Nr.592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", (i ndryshuar), pika 6/d, si dhe shkreses se Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit Nr.2879 Prot. date 26.04.2024, bashkangjitur ju paraqesim per miratim P/Vendimin:

"Per ndryshimin e kategorise se perdorimit te sip. prej 0,677 ha nga fondi pyjor dhe kullosor, per objektin "shfrytezim mineral kromi" per lejen minerare 1886/1 ne funksion te aktivitetit te shoqerise "Pepa Group" sh.p.k

Ne baze te VKM Nr.433, datë 08.06.2016, Bashkive iu transferuan në pronësi sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listave të inventarit bashkangjitur ketij vendimi (i ndryshuar), me VKM-në Nr.684, datë 02.90.2020. Sipas dispozitave te percaktuara ne nenin 5 te ligjit Nr.57/2020, "Per Pyjet" date 30.04.2005, si dhe nenin 10 te ligjit Nr.9693, date 19.03.2007 (i ndryshuar), njesite e veteqeverisjes vendore ne ushtrimin efektiv të funksioneve,

kompetencave dhe realizimit të detyrave, për kërkesat e paraqitura nga subjekte juridike ose fizike për veprimtari minerare e gjeologjike, etj. kanë të drejtë që të zbatojnë procedurat ligjore për:

- *Ndryshimin e kategorise se perdorimit (heqjen) e një kullote apo livadhi nga fondi kullosor ose ndryshimin e destinacionit për një sipërfaqe kullote.*
- *Ndryshimin e kategorise se perdorimit (heqjen) nga fondi pyjor të pyjeve dhe tokave me bimësi pyjore.*

Ministria Mjedisit e Turizmit dhe Mjedisit për Subjektin ekonomik **“Pepa Group” sh.p.k** i cili ushtron aktivitetin e tij në fushën e shfrytëzimit mineral i paisur me leje minerare nr 1886/1 me Nr 386/1 prot date 07/02/2023 nga MIE është drejtuar me shkresën nr 2879 prot date 26/04/2024 Bashkisë ku kerkone studimin tekniko-ekonomik për sipërfaqen e reduktuar, që hiqet nga fondi pyjor public, e cila ndodhet brenda zonës së lejuar të lejes shfrytëzimit të miratuar nga MIE, dhe dakortësive të keshillit bashkiak për vazhdimin e procedurave për ndryshimin e kategorise se perdorimit (heqje) të fondi pyjor /kullosore.

Subjekti me kerkese është drejtuar Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, dhe ka kërkuar ndryshimin e kategorise se perdorimit (heqjen) të një pjese të fondit pyjor/kullosore që preket nga shfrytëzimi i mineralit të kromit (cr).

1. Proçedura për ndryshimin e kategorise se perdorimit (heqjen) nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqes prej 0,677 ha e cila preket nga aktiviteti i shfrytëzimit mineralit të kromit, kalon nëpër disa faza, si më poshtë vijon:

a). Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën Nr 2879 Prot. date 26.04.2024, bazuar në VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhenies në përdorim dhe ndryshimin e kategorise se perdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakesimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” si dhe VKM Nr.1374, date 10.10.2008 (i ndryshuar) i ka kërkuar Bashkisë Kukes dhenien e dakortësive për heqjen nga fondi pyjor bazuar në raportin tekniko-ekonomik të përgatitur nga Drejtoria Administrimit Pyjor dhe Kullotave për sipërfaqen pyjor/kullosore që preket nga aktiviteti shfrytëzimit mineral.

b). Nga Drejtoria Administrimit Pyjor dhe Kullotave Bashkia Kukes është hartuar raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqen e propozuar, për heqje nga fondi pyjor/kullosore.

- Sipas të dhënave të regjistrit kadastral pyjor/kullosor, rezulton se sipërfaqja e propozuar shtrihet në ngastrat ,92/b e cila bën pjese në ekonomine pyjorë Mamez-Kalimash në pronësi të Bashkisë Kukes.
- Raporti i hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, përmban një studim të hollësishëm të të dhënave mbi listen e ngastrave/nenngastrave, përshkrimin e sipërfaqes pyjor/kullosore, vlerësimin financiar të sipërfaqes së propozuar.

c).Pas shqyrtimit te kerkeses se paraqitur nga subjekti, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresen Nr.2879 Prot. date 26.04.2024 drejtuar Bashkise Kukes, kerkon miratimin me shkrim nga Keshilli Bashkiak për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor.

d).Sipas pikes 2/d te VKM Nr.888, datë 27.12.2022 si dhe pikes 6/d te VKM Nr.592, datë 9.10.2018, percaktohet se:

Miratimi me shkrim për vazhdimin e procedurave të ndryshimit te kategorise se perdorimit te fondi pyjor kombetar nga ana e Këshillit Bashkiak, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore/kullosore publike, si dhe per sipërfaqen pyjore ne pronesi private, e cila do ti nenshtrohet procedurave te ndryshimit te kategorise se perdorimit (paksim/shtese), si dhe verifikimi ligjshmerise nga prefekti, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

2. Meqenese sipërfaqja e propozuar eshte me e vogel se 1 ha, sipas percaktimit ne shkronjen "a", te pikes 4, nenit 5 te ligjit Nr.57/2020, "Per Pyjet" date 30.04.2005 si akteve nenligjore te miratuara ne zbatim te tij, ministria e linjes përgatit urdherin e ministrit për ndryshimin e kategorise se perdorimit (heqje) te sipërfaqes nga fondi pyjor, për pyje dhe toka, me bimësi pyjore.

a).Pas miratimit të procedurave ligjore te heqjes së sipërfaqes nga fondi pyjor/kullosor behen disa veprime nga strukturat e meposhtme:

- Drejtoria përkatëse e Administrimit te pyjeve dhe kullotave bën përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe në vëllim dhe të dhënat i përcjell në ministri;
- Ministria bën përditësimin në Kadastrën Kombëtare të Pyjeve;

Sa me siper, i propozojme Keshillit Bashkiak Kukes, dhenien e dakortesise per vijimin e procedurave ligjore te ndryshimit te kategorise se perdorimit (heqjes) nga fondi pyjor/kullosor te sipërfaqes per kryerjen e aktivitetit shfrytezim mineral kromi me karrjere ne objektin " Surroj" nga subjekti "**Pepa Group**" sh.p.k.

Ju faleminderit !

DREJTORI
Sali HALLAÇI